



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

NJOFTIM PËR MEDIA

Ditën e mërkurë, në datën 07 mars 2019, u zhvillua mbledhja e radhës së Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), ku morën pjesë anëtarët e mëposhtëm:

Gentian	SALA	Kryetar
Sami	NEZAJ	Zëvendëskryetar
Gledis	GJIPALI	Anëtar
Piro	MISHA	Anëtar
Suela	MUSTA	Anëtar
Zylyftar	BREGU	Anëtar

AMA, pasi shqyrtoi çështjet e rendit të ditës, vendosi:

1. “Përcaktimin e subjekteve audiovizive analogë lokalë/rajonale që përfshihen në skemën e kompensimit financiar sipas ligjit nr. 34/2017 “Për lirimin e frekuencave të Dixhital-Dividentit” të ndryshuar.” (**Vendimi nr. 38, datë 07.03.2019**)
2. “Përcaktimin e listës së subjekteve me eksperiencë në transmetimet numerike dhe operatorët privatë historikë kombëtarë që përfshihen në skemën e kompensimit financiar sipas ligjit nr. 34/2017 “Për lirimin e frekuencave të Dixhital-Dividentit” të ndryshuar.” (**Vendimi nr. 39, datë 07.03.2019**)
3. “Për miratimin e kriterëve për ndarjen e kompensimit financiar të operatorëve privatë historikë kombëtarë dhe operatorëve me eksperiencë në transmetimet numerike sipas ligjit nr. 34/2017 “Për lirimin e frekuencave të Dixhital-Dividentit” të ndryshuar”. (**Vendimi nr. 40, datë 07.03.2019**)
4. “Për miratimin e rregullores “Për transmetimin e raporteve të shkurtra të ngjarjeve me rëndësi të madhe për publikun”. (**Vendimi nr. 41, datë 07.03.2019**)
5. “Rinovimin e licencës së shoqërisë “City FM” sh.p.k., për subjektin audio privat vendor “City FM”. (**Vendimi nr. 42, datë 07.03.2019**)
6. “Pranimin e kërkesës së shoqërisë “DIGICOM” sh.p.k., autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në internet IPTV, duke azhurnuar zonën e ofrimit të shërbimit nga “Bashkia Tiranë”, në “Njësinë administrative Tiranë”. (**Vendimi nr. 43, datë 07.03.2019**)
7. “Rinovimin e autorizimit të subjektit, person fizik Milika Nito, për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tv Kabllor Ura Vajgurore”. (**Vendimi nr. 44, datë 07.03.2019**)
8. “Rinovimin e autorizimit të subjektit person fizik Sevi Mediu, për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tv Kabllor Anfab”. (**Vendimi nr. 45, datë 07.03.2019**)
9. “Rrëzimin e aplikimit të shoqërisë “Vlora Cable” sh.p.k., autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “TV Kabllor

Vlora Cable”, për zgjerimin e zonës së ofrimit të shërbimit”. (**Vendimi nr. 46, datë 07.03.2019**)

10. “Dhënien e autorizimit, shoqërisë “Next Tv” sh.p.k., për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv online “Next TV”. (**Vendimi nr. 47, datë 07.03.2019**)

Tiranë, 07 mars 2019

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE